

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

**Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2008
Me raportin e auditorëve te pavarur**

Përmbajtja

	<u>Faqe</u>
Raporti i auditorëve te pavarur	i
Bilanci kontabël më 31 Dhjetor 2008	1
Pasqyra e te ardhurave për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008	2
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008	3
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008	4
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për fundin e vitit 31 Dhjetor 2008	6 – 41



KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania
NIPT J91619001D

Telephone +355 4 2274 524
+355 4 2274 534
Telefax +355 4 2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raport i Audituesit të Pavarur

Tiranë, 10 Prill 2009

Pronarëve të Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k

Ne kemi audituar bilancin kontabël bashkëlidhur të Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k ("Shoqeria") për ushtrimin e mbyllur me datë 31 Dhjetor 2008 dhe pasqyrat përkatëse të të ardhurave, ndryshimet e kapitalit dhe të fluksit të parasë për fundin e vitit dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Pergjegjësia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në pajtim me Standartet Shqiptare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe ruajtjen e kontrollit të brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale, që mund të jenë pasojë e gabimeve apo mashtrimit; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave kontabël të duhura; dhe bërjen e çmuarjeve kontabël të cilat janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej gabimit apo mashtrimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqerisë. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.



Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjendjen financiare të Shoqërisë me datë 31 Dhjetor 2008, për rezultatet e veprimtarive të saj dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në pajtim me Standartet Shqiptare të Kontabilitetit.

KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana
Albania

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Bilanci kontabël me 31 Dhjetor 2008

(shumat ne Lek)

	Shënimi	31 Dhjetor 2008	31 Dhjetor 2007
Aktivet			
Toka, ndërtesa dhe makineri	6	1,285,787,592	1,350,462,676
Investime financiare	7	23,000,000	23,000,000
Aktive te tjera afatgjata	12	1,626,532	4,106,532
Tatim i shtyrë	8	1,565,969	2,784,336
Totali i aktiveve afatgjata		<u>1,311,980,093</u>	<u>1,380,353,544</u>
Inventari	9	186,888,996	212,801,468
Kërkesa për arkëtim nga debitorët	10	65,123,049	105,630,074
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	11	41,650,346	116,505,849
Tatim fitimi i parapaguar	28	-	1,682,093
Aktive te tjera afatshkurtra	12	63,356,323	83,331,630
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	13	320,376,739	78,365,378
Totali i aktiveve afatshkurtra		<u>677,395,453</u>	<u>598,316,492</u>
Totali i aktiveve		<u>1,989,375,546</u>	<u>1,978,670,036</u>
Detyrimet dhe kapitalet e veta			
Kapitali i nënshkruar	14	1,493,040,000	1,402,387,000
Rezerva statutore	15	-	90,653,200
Rezerva ligjore	16	19,702,550	11,260,181
Rezerva te tjera	16	8,442,169	-
Fitimi i mbartur		222,582,425	185,720,673
Totali i kapitalit aksionar		<u>1,743,767,144</u>	<u>1,690,021,054</u>
Detyrime afatgjata	17	4,116,542	14,048,471
Tatim i shtyre	8	22,641,562	22,526,448
Detyrime ndaj palëve te lidhura	18	6,082,843	5,983,591
Totali i detyrimeve afatgjata		<u>32,840,947</u>	<u>42,558,510</u>
Detyrime afatshkurtra	17	10,153,522	10,756,279
Detyrime ndaj palëve te lidhura	18	5,655,184	11,062,659
Furnitorë	19	106,605,120	171,761,392
Detyrim për tatim fitimi		1,345,609	0
Detyrime te tjera	20	89,008,020	52,510,142
Totali i detyrimeve afatshkurtra		<u>212,767,455</u>	<u>246,090,472</u>
Totali i detyrimeve dhe kapitaleve te veta		<u>1,989,375,546</u>	<u>1,978,670,036</u>

Bilanci kontabël duhet lexuar se bashku me shënimet shpjeguese dhe pjese përbërëse te pasqyrave financiare ne faqet 6 deri 41.



Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Pasqyra e te ardhurave për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(shumat ne Lek)

	Shënimi	2008	2007
Te ardhurat nga shitjet	22	2,325,072,404	2,673,707,003
Kostoja e mallrave te shitura	23	<u>(1,686,717,456)</u>	<u>(2,048,526,306)</u>
Fitimi bruto		<u>638,354,948</u>	<u>625,180,697</u>
Te ardhura te tjera	24	232,444,171	178,671,137
Shpenzime personeli	25	(138,460,504)	(109,819,922)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale		(55,001,815)	(56,202,824)
Shpenzime te tjera operative	26	<u>(439,167,059)</u>	<u>(425,013,147)</u>
Shpenzimet operative		<u>(400,185,207)</u>	<u>(412,364,756)</u>
Fitimi operativ para kostove financiare		238,169,741	212,815,941
Shpenzime financiare		(30,546,615)	(40,270,339)
Te ardhura financiare		<u>23,901,041</u>	<u>48,245,798</u>
(Shpenzime)/ te ardhura financiare, neto	27	<u>(6,645,574)</u>	<u>7,975,459</u>
Fitimi para tatimit		231,524,167	220,791,400
Tatimi mbi fitimin	28	(25,819,034)	(26,222,633)
Fitimi neto për periudhën		<u>205,705,133</u>	<u>194,568,767</u>

Pasqyra e te ardhurave duhet lexuar se bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesë përbërëse te pasqyrave financiare ne faqet 6 deri 41.



Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera në Lek)

	Kapitali aksionar	Rezerva statutore	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja me 31 Dhjetor 2006	1,402,387,000	90,653,200	8,040,085	-	55,553,830	1,556,634,115
Kalimi i fitimit në rezervë	-	-	3,220,096	-	(3,220,096)	-
Pagesa për dividende	-	-	-	-	(61,181,828)	(61,181,828)
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	194,568,767	194,568,767
Gjendja me 31 Dhjetor 2007	1,402,387,000	90,653,200	11,260,181	-	185,720,673	1,690,021,054
Kalimi i fitimit në rezervë	-	-	8,442,169	8,442,169	(16,884,338)	-
Kalimi i rezervave në kapitalin aksionar	90,653,000	(90,653,200)	200	-	-	-
Pagesa për dividende	-	-	-	-	(151,959,043)	(151,959,043)
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	205,705,133	205,705,133
Gjendja me 31 Dhjetor 2008	1,493,040,000	-	19,702,550	8,442,169	222,582,425	1,743,767,144

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesë përbërëse të pasqyrave financiare në faqet 6 të 41.



Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Pasqyra e flukseve monetare

për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlerat ne Lek)

	2008	2007
Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi neto i periudhës:	205,705,133	194,568,767
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizim	181,370,986	186,478,239
Humbje/(fitim) nga shitja e aktiveve materiale	(99,403)	375,683
Nxjerrje jashtë përdorimi e aktiveve materiale	32,405,516	52,883,543
Provizion për inventarin	9,452,722	20,711,030
Fitim i parealizuar nga kursi i këmbimit	(1,429,182)	(3,573,753)
Tatim fitimi	26,731,350	60,000,978
Te ardhura nga interesi	(851,855)	(358,754)
Te ardhura nga dividente	(479,272)	(341,667)
Shpenzime interesi	2,114,577	2,325,378
Fitimi operativ para ndryshimit te kapitalit qarkullues:	454,920,571	513,069,444
Ndryshimi ne inventarë	16,459,750	(18,156,024)
Ndryshimi kërkesa për arkëtim te palëve te lidhura	75,013,656	(54,570,170)
Ndryshimi ne kërkesa për arkëtim	40,507,025	(87,481,601)
Ndryshimi i kërkesave te tjera për arkëtim	22,455,307	4,940,422
Ndryshimi ndaj palëve te lidhura	(5,304,155)	(23,767,611)
Ndryshimi ne detyrimet e pagueshme	(63,375,521)	(22,259,569)
Ndryshimi ne detyrimet te tjera te pagueshme	36,497,878	12,852,000
Mjete monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit	577,174,511	324,626,891
Tatimi mbi fitimin i paguar	(22,370,165)	(65,419,508)
Interesi i paguar	(2,114,577)	(2,325,378)
Interesi i arkëtuar	851,855	358,754
Mjete monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit	553,541,624	257,240,759
Mjete monetare nga aktiviteti investues		
Dividente te arkëtuar	479,272	341,667
Blerje e aktiveve afatgjate materiale	(149,460,349)	(181,668,237)
Te ardhura nga shitjet e automjeteve	458,333	896,998
Mjete monetare neto nga veprimtaritë investuese	(148,522,744)	(180,429,572)



Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Pasqyra e flukseve monetare (vazhdim) për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlerat ne Lek)

	2008	2007
Mjete monetare nga aktiviteti financues		
Dividente te paguar	(151,959,043)	(61,181,828)
Shlyerje e detyrimeve financiare	(11,048,476)	(23,673,181)
Mjete monetare neto nga veprimtaritë e financimit	(163,007,519)	(84,855,009)
Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to	242,011,361	(8,043,822)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne 1 Janar	78,365,378	86,409,200
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 Dhjetor (shënimi 13)	320,376,739	78,365,378

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar se bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesët përbërëse te pasqyrave financiare ne faqet 6 deri 41.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi i Drejtuesve te Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k. me 10 Prill 2009 dhe te firmosura nga:



Fatime Lalo
Shefe Kontabiliteti



Flora Lami
Drejtore e Përgjithshme

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

1. Historiku i Shoqërisë

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k. ("Shoqëria") është themeluar në Qershor të 1993, si një shoqëri me kapital të përbashkët ndërmjet Aziende Commerciali Industriali e Servizi s.r.l. ("ACIES") një shoqëri italiane me zyrat qendrore në Bolonja, Itali, Coca-Cola Export Corporation ("TCCEC"), e themeluar në shtetin e Delaware, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe Invest P.F., një Shoqëri me kapital shtetërore shqiptare me zyrat qendrore në Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria është angazhuar në prodhim, mbushjen dhe në shitjen e gjithë produkteve të markës Coca-Cola në Shqipëri, sipas një kontrate franchize ekskluzive me shoqërinë Coca-Cola.

Aksioneret e shoqërisë dhe numri i aksioneve respektive janë si me poshtë:

Aksionaret	Ne %	
	31 Dhjetor 2008	31 Dhjetor 2007
ACIES	51.69	74.69
SIBEG	23.00	-
TCCEC	22.65	22.65
INVEST P.F.	2.66	2.66
	<u>100.00</u>	<u>100.00</u>

Shoqëria është vendosur ne Kashar, 5 km nga Tirana, (Shqipëri) dhe ka 236 punonjës në 31 Dhjetor 2008 (2007: 240 punonjës).

1. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur ne përputhje me Standartet Shqiptare te Kontabilitetit te cilat jane Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar (SNRF) te përkthyer nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit te Republikës se Shqipërisë dhe te shpallura nga Ministri i Financave. Duke filluar nga data 1 Janar 2008 aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare te Raportimit Financiar u be kërkesë ligjore per shoqërinë. Shoqëria i adopton për here te pare Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar. Një shpjegim i ndikimit qe ka patur kalimi ne SNRF ashtu si jane përkthyer nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit te Republikës se Shqipërisë ka ndikuar ne pozicionin financiar te raportuar ne bilancin e çeljes 1 Janar 2007, ne performancën financiare te Shoqërisë ne fund te vitit me 31 Dhjetor 2007 jepet ne Shënimin 32.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar ne koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur ne Lek, e cila është monedhe funksionale për shoqërinë.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

2. Baza e përgatitjes

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përsërkruhen në paragrafët me poshtë:

(i) Humbje nga rënia e vlerës se aktiveve financiare

Shoqëria teston vlerën e aktiveve të saj financiare rregullisht për të konstatuar rënie të mundshme vlere. Për të përcaktuar nëse një rënie e mundshme vlere duhet njohur në pasqyrën e të ardhurave, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dallueshme që të ketë një rënie të matshme në flukset monetare të pritshme nga portofoli i aktiveve financiare, përpara se ulja të identifikohet e ekspozuar individualisht në portofol.

Kjo evidence mund të përfshijë të dhëna të dallueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim jo të favorshëm në gjendjen e pagesave të klientit në Shoqëri, apo në gjendjen ekonomike kombëtare apo lokale që lidhet me mospagesat në aktivet e Shoqërisë.

(ii) Përcaktimi i vlerës se drejte

Përcaktimi i vlerës se drejte për aktivet financiare dhe detyrimet për të cilat nuk ka një çmim tregu të dallueshëm, kërkohet përdorimi i teknikave vlerësuese siç përshkruhet në shënimin 4 në pasqyrat financiare.

(iii) Përlllogaritja e tatimit fitimit

Duke filluar nga 1 Janari 2008, Shoqëria aplikon si kuader kontabël për qëllime ligjore Standardet Ndërkombëtare Financiare të Raportimit. Për rrjedhojë, aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare Financiare të Raportimit, të përkthyer nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit i Republikës së Shqipërisë, mundëson bazën për regjistrimet themelore kur entiteti është subjekt i tatimit të fitimit. Sidoqoftë, në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, ekzistojnë udhëzime të kufizuara mbi përlllogaritjen e tatimit mbi fitimin si pasojë e futjes së Standardeve Ndërkombëtare Financiare të Raportimit si kuader kontabël për qëllime ligjore. Drejtimi beson se përlllogaritja e tatimit mbi fitimin është prudent duke pasur parasysh ambientin fiskal shqiptar dhe legjislacionin ekzistues në fuqi dhe rezultatet e mundshme të çdo inspektimi tatimor, nuk do të ketë ndikim sinjifikativ në pozicionin financiar, rezultatit operative apo flukset monetare të Shoqërisë.

Politikat kontabël të paraqitura me poshtë janë aplikuar qëndrueshëm në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

3. Përmbledhja e politikave kontabël

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka).

(b) Instrumentet financiare

Instrumente financiarë jo-derivativë te Shoqërise përfshijnë llogari të arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, dhe llogari të pagueshme. Gjate periudhave te raportimit nuk ka investime ne letra me vlere.

Instrumentet financiarë jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumenteve financiarë jo-derivativë përshkruhet më poshtë

Nje instrument financiar njihet në rast se Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktiviteti financiar perndujone, ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktiviteti financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, psh datën në të cilën Shoqëria zotohet të blejë ose të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogarite rrjedhëse në banka. Për qëllime te fluksit te mjeteve monetare, këtu përfshihen edhe depozitat ne formën e garancisë për huat me maturitet me shume se 3 muaj ose me pak nga data origjinale.



Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

3. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(b) Instrumentet financiare(vazhdim)

Kërkesa për arkëtim

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuara për humbjet për zhvlerësime.

Llogari te detyrime te pagueshme

Llogaritë e detyrimeve te pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

Hua dhe kredi

Në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe dreditë paraqiten me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së riblerjes që njihet në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës së huamarrjes në bazat e interesit efektiv.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

Te tjera

Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabiliteti për të ardhurat dhe shpenzimet financiare shpjegohet ne shënimin3(k).

(c) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka).

Kostoja e ndertesës është rivlerësuar me vlerën e drejtë më 1 Janar 2007, data e kalimit në SNRF, dhe matur ne baze te koston se gjykuar e cila është vlera e rivlerësuar në datën e kalimit ne SNRF.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi, koston e çmontimit dhe te zhvendosjes se njësisve, kthimin e vendqëndrimit ku ato ndodhen. Shpenzimet kapitale për kontributin në aktive kalojnë në llogarinë "Punime në proces" dhe kapitalizohet duke u transferuar në kategorinë e aktivit përkatës kur ai ka mbaruar, e në këtë kohë fillon dhe aplikohet amortizimi me normën përkatëse të kategorisë.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.



Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

3. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(c) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(ii)Kostot e vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do ti rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin

(iii) Amortizimi

Amortizimi i tokës me qera, ndërtesave dhe instalimeve teknike nuk llogaritet me metoden lineare, nërsa amortizimi i pajisjeve të tjera llogaritet duke përdorur metodën zbritëse të amortizimit e cila është e perafert me jeten ekonomike. Toka dhe punimet ne proces nuk amortizohen. Normat respektive të amortizimit per periudhen raportuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

	2008
Ndërtesa	5%
Makineri dhe pajisje	20%
Pajisje dhe frigoriferë	20%
Mjete transporti	20%
Pajisje zyrash, mobilje dhe orendi	20-25%
Tokë me qera	1.01%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) të aktiveve materiale afatgjate janë rishikuar në datën e raportimit.

(d) Aktivet e marra me qira

Aktivitet e marra me qira janë te klasifikuara si qira financiare kur termat e transferimit te risqeve dhe pronësisë kalojnë te qiramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera janë të klasifikuara si qera operative.

Asetet që janë rregjistruar si qera financiare rregjistrohen si asete te Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillimit të qerasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë nëse kjo e fundit është me e vogël.

Pagesat e qerasë regjistrohen si shpenzimeve financiare dhe zvogëlimit të detyrimit të qerasë që të arrijë një normë konstante të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimit.

(e) Inventarët

Mallrat vlerësohen me vlerën me te vogël te kosos dhe vlerës neto te realizueshme. Kostoja përfshin materialet direkte dhe punën direkte kur është e aplikueshme dhe kostot e tjera që janë shpenzuar për te sjelle inventarët ne gjendjen dhe vendin aktual. Vlera neto e realizuar tregon vlerën e çmuar te çmimit te shitjes ne aktivitetin e biznesit, duke i zbritur koston e çmuar te marketingut, shitjes dhe shpërndarjes. Kostoja e inventarëve te tjerë është bazuar ne parimin FIFO (e hyra e pare e dala e pare) dhe përfshin shpenzimet e përdorura ne përvetësimin e inventarit dhe për ti sjelle ato ne kushtet dhe vendin e tyre ekzistues. Shuma e përshtatshme për zhvlerësim njihet ne pasqyrën e te ardhurave kur ka një evidence objektive që aktivi është zhvlerësuar.



Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Zhvlerësimi

(i) Aktivët financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive zhvlerësimi tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të vlefshëm për shitje është llogaritur kundrejt vlerës së tij të drejte.

Aktivët financiarë të cilat janë të konsiderueshme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet se bashku në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme risku.

Te gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Ndonjë humbje kumulative në lidhje me aktivët financiarë të vlefshme për shitje të njohura me pare në letra me vlere transferohet tek humbje fitimi.

Një humbje nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Aktivët jo-financiarë

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiarë të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Humbjet nga zhvlerësimi në periudhat e mëparshme janë rishikuar në çdo datë raportimi për rastet kur humbja rritet ose nuk ekziston më. Një humbje zhvlerësimi anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për caktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(g) Përfitimet e punonjësve

Sigurime shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve për gjatë periudhës.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

3. Përmbledhje te politikave kontabël (vazhdim)

(h) Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve te kaluara dhe është e mundur qe një rrjedhje e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do te jete e nevojshme për te rregulluar detyrimin dhe një vlerësim te besueshëm te vlerës se detyrimit qe mund te behet. Nëse efekti është material, provigjionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme te mjeteve monetare te ardhme para tatimit qe reflekton vlerësimet aktuale te tregut për vlerën ne kohe te parasë, dhe kur është e nevojshme riskun specifik te detyrimit. Provigjionet paraqiten ne çdo date bilanci dhe nëse nuk është akoma e mundur qe rrjedhja e burimeve duke personifikuar burime ekonomike te përdoret për rregullimet e detyrimeve, provigjionet anulohen. Provigjionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provigjionet nuk njihen për humbje shfrytëzuese te ardhme. Aktivet dhe detyrimet e rastit nuk njihen..

(i) Njohja e te ardhurave

Te ardhurat maten me vlerën e drejte të shumës se marre ose për tu arkëtuar dhe përfaqëson vlerën e arketueshme për te mirat dhe shërbimet te siguruar gjate aktivitetin normal te biznesit, neto nga zbritjet dhe shitjet te lidhura me taksen.

Shitjet e mallrave njihen kur mallrat janë dërguar dhe gjithashtu kanë kaluar dhe pronësinë e tyre. E ardhura nga shërbimet e kryera njihet ne pasqyrën e te ardhurave ne përpjesëtim me volumin e shërbimit te kryer ne datën e bilancit. Volumi i shërbimit vlerësohet duke iu referuarurvejimeve te punës se kryer.

(j) Rimbursimet e kostos se marketingut dhe kostove te shitjes

Rimbursimet për programet e marketingut për te promovuar shitjen e produkteve te licensuara janë te njohura si te ardhura te vitit ne te cilin kanë ndodhur dhe shpenzimet përkatëse. Rimbursimi i kostove te shitjes është njohur si e ardhur ne te njëjtën kohe me shitjet e produkteve te cilave i referohet.

(k) Shpenzimet

Pagesat e qerave

Pagesat e bëra për qeratë operationale njihen ne fitim ose humbje me mënyrën lineare gjate periudhës se qirasë. Stimujt e qirasë se marre njihen si një pjese integrale e shpenzimeve totale te qirasë, gjate periudhës se qirasë.

Minimumi i pagesave të qerasë të bëra nën qeratë financiare janë shpërndarë midis shpenzimeve fianciare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar është shpërndarë në cdo periudhë të termave të qerasë për të krijuar nje norme interesi konstante periodike mbi tepricën e mbetur të detyrimit.

Te ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuar në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, skonto të pazbritshme mbi provigjionin, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huave njihen ne pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv.



Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

3. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(l) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatim fitimi njihet si zë i kapitalit.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyre llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatimor që janë ose hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktivit tatimor i shtyrë zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

(m) Standarte dhe interpretime te reja ende te pa-adoptuara

Siç është shpjeguar në shënimin 2.a Shoqëria ka aplikuar SNRF-te të përkthyer nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të Republikës së Shqipërisë e cila përdor ato Standarte të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standarteve të Kontabilitetit (BNSK) që nga 1 Janari 2007. Shoqëria ka përdorur në mënyrë vullnetare ato Standarte, amendamente dhe interpretime të publikuara nga BNSK por që nuk janë të përkthyer nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të cilat janë publikuar por nuk janë akoma efektive për fund vitin 31 Dhjetor 2008. Standardet që janë publikuar por që nuk janë akoma efektive për fund vitin 31 Dhjetor 2007 nuk janë konsideruar relevante për aktivitetin e shoqërisë.

Po ashtu në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare një numer Standartesh dhe Interpretimesh që janë publikuar nga BNSK, por të papërkthyer, por nuk janë bërë ende efektive në fund të vitit 31 Dhjetor 2008, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Disa nga këto që mund të jenë relevante për veprimet e Shoqërisë janë si më poshtë:

- Rishikimi i SNRF 2 *Pagesa e Bazuara në Aksione* sqaron përkufizimin e konditave të kushtëzimit dhe prezanton konceptin e konditave jo-kushtëzuese. Konditat jo-kushtëzuese duhen reflektuar me vlerën e drejtë në datën e dhënies dhe dështimi në përbushjen e konditave jo-kushtëzuese do të rezultojë përgjithësisht në trajtimin si anulim. Ndryshimet në SNRF 2 do të bëhen të detyrueshme për pasqyrat financiare të Shoqërisë në 2009, dhe nuk janë relevante për veprimtarinë e Shoqërisë pasi Shoqëria nuk ka ndonjë plan kompensimi të pagesave të përbashkëta.



Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(I) Standarte te reja dhe interpretime ende te pa-adoptuara (vazhdim)

- SNRF 3 i rishikuar, *Kombinimet e Biznesit* (efektive për periudha vjetore duke filluar nga data 1 Korrik 2009) ka rishikuar qëllimin e standardit dhe përkufizimi i një biznesi është zgjeruar. Standardi i rishikuar gjithashtu përfshin një sërë ndryshimesh të tjera domethënëse duke përfshirë:

- Të gjitha elementet e transferuara nga blerësi, njihen dhe maten me vlerën e drejtë në datën e blerjes, duke përfshirë edhe elemente të kushtëzuara.
- Ndryshime të mëvonshme në elementet e kushtëzuara do të njihen në pasqyrën e të ardhurave.
- Kostot e transaksionit, përveç kostove të emetimit të aksioneve dhe instrumenteve të borxhit, do të njihen kur ndodhin.
- Blerësi mund të zgjedhë të masë interesat e pakicës me vlerën e drejtë në datën e blerjes (emrin e mirë të plotë), ose interesin e tij proporcional në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të identifikuar të shitësit, mbi bazë transaksion pas transaksioni.

SNRF 3 i rishikuar do të bëhet i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Shoqërisë në 2009, dhe nuk është relevant për veprimtaritë e Shoqërisë duke qenë se Shoqëria nuk ka ndonjë interes në filiale që do të ndikohen nga rishikimi i këtij Standardi.

- SNRF 8 *Segmentet e Shfrytëzimit* (te vlefshme nga data 1 Janar 2009) prezanton “sjelljen e drejtimit” për segmentin raportues dhe kërkon informacion shpjegues për segmentet bazuar në përbërësit e njësisë ekonomike, të cilin drejtimi e përdor për të marrë vendime në lidhje me çështje të veprimtarive të shfrytëzimit. Segmentet operues janë përbërës të një njësie ekonomike për të cilët përgatiten informacione financiare të veçanta që vlerësohet rregullisht nga shefi i vendimmarrjes së shfrytëzimit të njësisë ekonomike, me qëllim që të shpërndajë burimet për segmentin dhe për vlerësimin e performancën së tij Shoqëria planifikon të bashkangjitet me politikat e Grupit dhe konsideron të aplikojë SNRF 8.

- SNK 1 i rishikuar *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (efektive nga data 1 Janar 2009) kërkon që informacioni në pasqyrat financiare të ndërthuret në bazë të karakteristikave të përbashkëta dhe prezanton një pasqyrë të të ardhurave përmbledhëse. Zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe përbërësit e të ardhurave të tjera përmbledhëse mund të paraqiten qoftë në një pasqyrë të vetme të të ardhurave përmbledhëse (duke kombinuar efektivisht pasqyrën e të ardhurave dhe të gjitha ndryshimet në kapital që nuk i përkasin pronarit në një pasqyrë të vetme), ose në dy pasqyra të ndryshme (një pasqyrë e veçantë e të ardhurave e ndjekur nga një pasqyrë për të ardhurat përmbledhëse). Shoqëria planifikon të paraqesi dy pasqyra të veçanta për pasqyrat financiare te vitit 2009.

- SNK 23 i rishikuar *Kostot e Huamarrjes* heq mundësinë për të shpenzuar kostot e huamarrjes dhe kërkon kapitalizmin e kostove të huamarrjes që lidhen me aktivet e kualifikuara (ato që kërkojnë një kohë të gjatë për të qenë gati për qëllim përdorimi apo shitje). SNK 23 i rishikuar nuk do të jete i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Shoqërisë në 2009 sepse nuk ka ndonje aktiv per te cilat kostot e huamarrjes mund te kualifikohen.

- Rishikimi i SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale* heq përkufizimin e “metodës së kostos” aktualisht i vendosur në SNK 27, dhe në vend të tij kërkon që të gjithë dividendët nga një filial, nga një shoqëri e kontrolluar bashkarisht ose nga një sipërmarrje, të njihen si e ardhur në pasqyrat financiare individuale të investitorit kur e drejta për marrjen e dividendit është vendosur. Për më tepër, rishikimi përfshin dhe udhëzime kur arkëtimi i të ardhurës nga dividendi konsiderohet të jetë një tregues për zhvlerësim. Rishikimi i SNK 27 nuk pritet të ketë ndonjë ndikim ne pasqyrat financiare kur te adoptohen.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(I) Standarte dhe interpretime te reja ende te pa-adoptuara (vazhdim)

- SNK 27 i rishikuar *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale* (i vlefshem per periudhat vjetore duke filluar nga data 1 Korrik 2009) ka zëvendësuar termin “interesi i pakicës” me “interesat e pakontrolluar”, dhe përcaktohet si “kapitali në filial i cili nuk atribuohet direkt ose indirekt tek shoqëria mëmë”. Standardi i rishikuar gjithashtu zgjeron kontabilizimin për interesat e pakontrolluara, humbjen e kontrollit në një filial, dhe shpërndarjen e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse ndërmjet interesave të kontrolluar dhe të pakontrolluar. SNK 27 i rishikuar nuk është i aplikueshëm për veprimtarinë e Shoqërisë dhe pasqyrat e vecanta te Shoqërisë.

- Rishikimi i SNK 32 *Instrumentet Financiarë : Paraqitja* dhe SNK 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (efektiv për periudha vjetore duke filluar nga data 1 Janar 2009). Rishikimi prezanton një përjashtim të parimit, ndryshe i aplikuar në SNK 32 për klasifikimin e instrumenteve si kapital; rishikimi lejon disa instrumente të kthimit të aksionit emetuar nga një njësi ekonomike që normalisht do të klasifikoheshin si detyrime të klasifikohen si kapital, atëherë dhe vetëm atëherë, kur ata përmbushin disa kushte të caktuara. Rishikimi nuk është relevant për veprimtarinë Shoqërisë duke qenë se ajo nuk ka emetuar në të shkuarën instrumente të kthimit të aksionit.

- Rishikimi i SNK 39, *Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja* (efektive për periudha vjetore duke filluar nga data 1 Janar 2009) - sqaron aplikimin e parimeve ekzistuese që përcaktojnë nëse rreziqe specifike ose pjesë të flukseve monetare janë të pranueshëm të përcaktohen në një marrëdhënie mbrojtje. Në përcaktimin e një marrëdhënie mbrojtje, rreziqet ose pjesa e fluksit të parave duhet të identifikohen qartë e dhe të maten në mënyrë të besueshme; sidoqoftë inflacioni nuk mund të përcaktohet, përveç se në rrethana të veçanta. Rishikimi i SNK 39 do të behet i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Shoqërisë në 2009, dhe nuk është relevant për veprimtarinë e Shoqërisë duke qenë se Shoqëria nuk e aplikon kontabilitetin mbrojtës.

- KIRFN 13 *Programet e Besnikërisë së Klientëve* (efektive për periudha vjetore duke filluar nga data 1 Janar 2008) - shpjegon se si njësite ekonomike që dhurojnë pikë krediti për besnikërinë e klientëve që blejnë mallra apo shërbime duhet të kontabilizojnë për detyrimin që kanë për të siguruar mallra ose shërbime falas ose me ulje (dhurata) ndaj klientëve të cilët do t'i kërkojnë ato kreditë. Njësi të tilla ekonomike duhet të alokojnë disa të ardhura nga shitjet fillestare tek pikët e kreditit dhe të njohin këto arketime si të ardhura vetëm kur i kane përmbushur detyrimet e tyre ndaj klientëve. Adoptimi i KIRFN 13 nuk do te rezultojë me një efekt ne te ardhura, fitime te mbajtura, dhe detyrimet jo aktuale te Shoqërisë meqë nuk ka kreditë te dhuruara prioriteteve konsumatoreve ne adoptimin e interpretimit.

- KIRFN 15 *Marrëveshjet për Ndërtimin e Pasurive të Patundshme* (efektiv për periudha vjetore duke filluar nga data 1 Janar 2009) sqaron se të ardhurat që rrjedhin nga marrëveshjet për ndërtimin e pasurive të patundshme njihen duke iu referuar fazës së realizimit të kontratës në rastet e mëposhtme:

- marrëveshja përmbush përcaktimin e një kontrate ndërtimi në përputhje me SNK 11.3;
- marrëveshja është vetëm për sigurimin e shërbimeve në përputhje me SNK 18 (p.sh., njësia ekonomike nuk kërkohet të furnizojë me materiale ndërtimit); dhe
- marrëveshja është për shitjen e mallrave por kriteri i njohjes së të ardhurave sipas SNK 18.14 përmbushen vazhdimisht ndërsa ndërtimi eshte ne proces.

Në të gjitha rastet e tjera, e ardhura njihet kur të gjitha kriteret e njohjes së të ardhurave sipas SNK 18.14 janë përmbushur (p.sh. në përfundim të punimeve të ndërtimit ose në dorëzim). IFRIC 15 nuk është relevant për veprimtarinë e Shoqërisë meqë Shoqërisë nuk siguron shërbime në ndërtimin e pasurive te patundshme dhe as nuk ndërton pasuri të paluajtshme për qëllime shitje.



Coca-Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(I) Standarte dhe interpretime te reja ende te pa-adoptuara (vazhdim)

- KIRFN 16 *Mbrojtjet e një Investimi Neto në një Njësi Ekonomike të Huaj* (efektive për periudhat vjetore duke filluar nga data 1 Tetor 2008) shpjegon llojin e ekspozimit që mund të mbrohet, në cilin grup duhet mbajtur zëri i mbrojtur, nëse metoda e konsolidimit e ndikon efektivitetin e mbrojtjes, forma që mund të marrë instrumenti mbrojtës, dhe cilat shuma janë riklasifikuar nga kapitali në pasqyrën e të ardhurave në momentin e mosnjohjes së njësisë ekonomike të huaj. IFRIC 16 nuk është relevant për veprimtarinë e Shoqërisë sepse Shoqëria nuk ka ndonjë investim në njësi ekonomike të huaja.

- KIRFN 17 *Shpërndarja e Aktiveve Jo-monetare ndaj Pronarëve* (efektive per periudhat vjetore duke filluar nga data 15 Korrik 2009). aplikohet për shpërndarjen jo-reciproke të aktiveve jo-monetare ndaj pronarëve në kapacitetin e tyre si pronarë. Në përputhje me Interpretimin, një detyrim për të paguar dividend duhet të njihet kur dividendi është autorizuar siç duhet dhe duhet të matet me vlerën e drejtë të aktiveve që do të shpërndahen. Vlera kontabël e dividendit të pagueshëm duhet të vlerësohet në çdo datë raportimi, dhe ndryshim në vlerën kontabël njihen në kapital si korigjim i vlerës për shpërndarje. Kur dividendi i pagueshëm shlyhet, diferenca (nëse ka) midis vlerës kontabël të aktiveve të shpërndara dhe vlerës kontabël të dividendëve të pagueshëm do të njihet në pasqyrën e të ardhurave. Meqenëse Interpretimi është i aplikueshëm vetëm prej datës së aplikimit, ai nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare për periudhat e mëparshme përpara datës së adoptimit të Interpretimit. Për më shume, meqenëse ai lidhet me dividendët e ardhshëm që do të jenë në zgjedhje të lirë të bordit të drejtorëve/aksionerëve, nuk është e mundur që të përcaktohet efekti i aplikimit në mënyrë paraprake.

- SNK 40, *Investimet ne aktive afatgjata* (efektive për periudha vjetore duke filluar nga data 1 Janar 2009). IAS 40 përfshin aktivet afatgjata ne ndërtim ose zhvillim për përdorim te mëvonshëm si investime ne aktive afatgjata ne përkufizimin e "Investimit ne aktive afatgjata". Këto rezultate ne aktive duke qene brenda qëllimit te SNK 40; me pare ka qene brenda qëllimit te SNK 16. Meqë Shoqëria nuk ka ndonjë investim ne aktive afatgjata ne ndërtim nuk janë te aplikueshme per aktivitet e Shoqërisë.

4. Përcaktimi i vlerës se drejte

Disa nga politikat kontabël dhe shenimet e pasqyrave financiare e Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës se drejte, për te detyrimet dhe aktivet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejte është përdorur për qëllime matjeje dhe zbulimi bazuar ne metodat e mëposhtme. Kur është e aplikueshme, informacione te mëtejshme rreth supozimeve te bëra për vlerën e drejte është paraqitur ne shënimin specifik te aktiveve dhe detyrimeve.

Kërkesa për arkëtim nga debitorët

Vlera e drejtë e kërkesave për arkëtim, klientëve dhe llogarive të tjera të arkëtueshme, është matur si vlera aktuale e flukseve të ardhshme, te skontuara me normën e interesit të tregut ne datën e raportimit.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

5. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- risku kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Menaxhimi mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për menaxhimin e riskut.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Bordi i Drejtoreve mbikëqyr se si drejtuesit monitorojnë përputhshmëritë me politikat, procedurat e rishikimet e administrimit të riskut të Grupit dhe Shoqërisë, si dhe përshtatshmërinë e kuadrit të administrimit të riskut në lidhje me rreziqet e përballuara nga Shoqëria.

Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në banka para, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera afatshkurtra..

Ndryshimet e shpeshta ne tregjet financiare globale dhe ne Shqipëri

Kriza e vazhdueshme financiare dhe ekonomike ka ndikuar, midis të tjerash, në një financim me te pakët të tregjeve të kapitaleve, nivele likuiditeti me te ulëta në sektorin bankar, si dhe ndonjë here norma interesi të borxhit nderbankar me te larta dhe ndryshueshmëri të shpeshte tek tregjet të aksioneve. Paqartësitë në tregjet financiare globale kanë sjelle edhe falimentimin e bankave si dhe ndihmave të dhëna ndaj bankave të tjera përgjatë gjithë globit. Shtrirja e plote e ndikimit të krizës financiare në vazhdim është duke provuar që është e pamundur që të parashikohet ose të jesh i mbrojtur plotësisht kundrejt saj.

Ndikimi ne likuiditete

Volumi i shitjeve me shumice është reduktuar në mënyre të ndejshme së fundmi. Rrethana të tilla mund të ndikojnë aftësinë e Shoqërisë të marrë hua të reja, nëse është e nevojshme, dhe të ri-financojë huat e ekzistuese me termat dhe rrethanat e ngjashme me ato të aplikuara në transaksionet e mëhershme.

Impakti ne debitor dhe huamarrës

Debitorët e Shoqërisë mund të ndikohen nga situata me likuiditet të ulët që mund të ulë aftësinë e tyre për të paguar. Përkeqësimi i kushteve operative për debitorët mund të ndikojnë gjithashtu menaxhimin e parashikimit të mjeteve monetare dhe supozimet e zhvlerësimeve të aktiveve financiare dhe jo-financiare. Për sa kohë informacioni është i vlefshëm, menaxhimi ka reflektuar në mënyrë të sakte parashikimet e mjeteve monetare të ardhme në zhvlerësimet e tyre.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2008

(Vlera ne Lek)

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë

Ne saje te limitit te volumit dhe llojshmërisë se bazës se klientëve te Shoqërisë, përqendrimet e riskut te kredisë ne lidhje me llogarite e arketueshme janë te limituara. Zhvlerësimi i llogarive të arketueshme mbahen në shumën e konsideruar te nevojshme për te mbuluar riskun potencial ne mbledhjen e tepricave te llogarive te arketueshme.

(b) Risku i likuiditetit

Shoqëria gjeneron mjete monetare nga aktivitetet operacionale saqë beson qe risku i likuiditetit nuk është domethënës. Për te reduktuar këtë risk Shoqëria ka lehtësime te vlefshme kredie për te financuar mjete monetare afatshkurta, nëse është e nevojshme.

Risku i tregut

Risku i normave te interesit

Shoqëria përballlet me riskun e normës së interesit të fluksit të parave në lidhje me overdrifte dhe hua qe Shoqëria mund te marr me norma variable. Menaxhimi nuk ka hyrë në ndonje derivative për të mbrojtur riskun.

Risku i kursit te këmbimit

Shoqëria nuk përballlet me riskun e kursit te këmbimit nga veprimet e saj normale. Sidoqoftë, ka gjendje te konsiderueshme Euro që i detyrohen klientët dhe vete Shoqëria kundrejt furnitorëve qe e ekspozojnë Shoqërinë ndaj riskut te normës se këmbimit. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky risk.

Analiza e ndjeshmërisë

